

Siguri

Shtatë krisma në orën 4 të mëngjesit në Prishtinë – misteriozi qëllon nga vetura dhe zhduket, Policia gjen gëzhoja 7.62 mm



Sinjali.com

25 Gusht 2026 09:37



Të shtëna me armë zjarri kanë trazuar një lagje në Prishtinë në orët e para të mëngjesit të së martës, ku një person ende i paidentifikuar dyshohet se ka shkrepur disa herë nga një veturë dhe më pas është larguar nga vendi, raporton Sinjali.

Ngjarja ka ndodhur më 25 gusht, rreth orës 04:10, në rrugën “Laura Shmani” në Prishtinë.

Burimet e Sinjalit bëjnë me dije se Policia është alarmuar nga një qytetar, i cili ka kërkuar të mbetet anonim dhe ka raportuar se një person kishte shtënë me armë zjarri nga një automjet.

Sipas informatave fillestare, bëhet fjalë për rreth shtatë të shtëna, pas të cilave personi është larguar me veturë në drejtim të panjohur.

Njësitë policore janë nisur menjëherë drejt lokacionit dhe, gjatë kontrollit të zonës, kanë hasur në gëzhoja të armës së zjarrit.

Në vendngjarje kanë dalë më pas edhe hetuesit dhe njësia e Forenzikës, të cilët kanë bërë ekzaminimin e lokacionit dhe sekuestrimin e gëzhojave.

Sipas informacioneve që ka siguruar Sinjali, gëzhojat e gjetura janë të kalibrit 7.62 mm.

Personi që dyshohet se ka shtënë ende nuk është identifikuar.

Për rastin është njoftuar Prokurori kujdestar, i cili ka udhëzuar Policinë që në këtë fazë rasti të evidentohet si shënim zyrtar dhe të vazhdojnë veprimet për identifikimin e personit të dyshuar.

Policia tashmë pritet të hetojë se kush ishte personi që qëllloi, automjetin me të cilin u largua dhe motivin e të shtënave.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera